



Co-funded by the
Europe for Citizens Programme
of the European Union



*Under the auspices of
the Secretary General of
the Council of Europe,
Mr. Thorbjørn Jagland*





European Rural Parliament²⁰¹⁷

Venhorst

Deklarata e Venhorstit

21 Tetor 2017



Ne, 250 pjesëmarrësit nga 40 vende evropiane, u takuam gjatë Parlamentit të 3të Rural Evropian në fshatin e Venhorst, Provinca e Brabantit Verior, Holandë, nga data 18 deri në 21 Tetor 2017, me mbështetjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve të Bashkimit Evropian, të disa qeverive kombëtare dhe të organizatave të shoqërisë civile nga shumë vende. I jemi mirënjohës për mikpritjen qytetarëve të Venhorst dhe për përpjekjen dhe mbështetjen organizative të *Vereniging Kleine Kernen Noord Brabant (VKKNB)*, autoriteteve dhe organizatave publike të Brabantit Verior, *Landelijke Vereniging voor Kleine Kernen (LVKK)* dhe qeverisë kombëtare të Holandës. Diskutuam nevojat e zonave rurale dhe formuam këshillim mbi mënyrën si të sigurohet mirëqenia e të gjitha komuniteteve rurale në të gjithë Evropën e gjërë.

U fokusuam mbi fuqinë e komuniteteve rurale për të ndërmarrë iniciativa dhe organizuam ekspedita dhe seminare mbi gjashtë tema kryesore: krijimi i komuniteteve të sigurta në të ardhmen, përmirësimi optimal i infrastrukturës dhe shërbimeve të komunitetit, përkujdesja e përbashkët dhe përfshirja e të tjerëve, zhvillimi i bazës ekonomike të komunitetit, marrja e vendimeve bashkërisht dhe mirëpritja e personave të rinj në komunitet. E pranojmë plotësisht urgjencën e situatës aktuale dhe sfidat kryesore me të cilat po përballlet Evropa aktualisht. Sfidat përfshijnë përhapjen e shpejtë të digjitalizimit dhe automatizimit, lëvizjet e popullsisë nga rajonet e varfra në ato të pasura dhe nga zonat rurale në qytete, ardhjen e refugjatëve në Evropë, humbjen e vazhdueshme të biodiversitetit, ndryshimin e klimës dhe ndikimin e tij në shumë pjesë të Evropës dhe stresi që pason mbi burimet e Bashkimit Evropian dhe autoritetet publike në të gjithë kontinentin. Komunitetet rurale janë në gjendje dhe të gatshëm të kontribuojnë në adresimin e këtyre sfidave.

Duke u bazuar më tej në Parlamentet Rurale Kombëtare dhe ngjarje të tjera të organizuara nga partnerët tanë evropianë dhe kombëtarë përgjatë dy viteve të fundit, diskutimi në Venhorst rezultoi me një thirrje qytetarëve dhe politikëbërësve për të mbështetur vitalitetin e zonave rurale dhe për të siguruar që politikat dhe programet e përgjithshme të jenë dashamirëse ndaj zonave rurale. Për më tepër, u bëjmë thirrje qytetarëve dhe politikëbërësve të asistojnë në krijimin e komuniteteve rurale të qëndrueshme në mënyrat që vijnë.

Infrastruktura, shërbimet dhe ndërlidhja

Mirëqenia sociale dhe ekonomike e shumë zonave rurale kërcënohet nga infrastruktura e dobët dhe nga humbja ose mungesa e shërbimeve thelbësore, të tilla si transporti publik, kujdesi shëndetësor dhe arsimimi. U bëjmë thirrje ofruesve të shërbimeve thelbësore, komuniteteve rurale dhe autoriteteve publike, që të mbështesin dhe zgjerojnë shërbimet dhe infrastrukturën moderne në zonat rurale; ose (aty ku nuk është e mundur) të punohet me komunitetet rurale për të gjetur zgjidhje novatore. Modele biznesi të reja duhet të zhvillohen për të siguruar qëndrueshmërinë e këtyre zgjidhjeve. Këto modele duhet të jenë të bazuara në komunitet në mënyrë që t'u sjellin përfitime gjallërisë dhe vitalitetit të komuniteteve lokale. Politikëbërësit kanë një rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin dhe financimin e digjitalizimit, internetit të një cilësie të lartë, energjisë së rinovueshme dhe shërbimeve të ekosistemit dhe zhvillimit të zgjidhjeve të transportit të zgjuar, dhe duke mbështetur zhvillimin e marrëdhënieve sinergjike rurale-urbane. Ata duhet të ligjërojnë në mënyrë që t'u japin komuniteteve të drejtën që të kujdesen për vetë objektet e shërbimeve të tyre në fshat, për shembull nëpërmjet të drejtës për të sfiduar dhe bërë oferta në projekte/tenderë. Financimi drejt sipërmarrjeve të komunitetit është i rëndësishëm. PRE-ja mund të luajë një rol duke grumbulluar praktikatat më të mira në iniciativat qytetare në këto fusha..

Trajtimi i varfërisë dhe përjashtimit shoqëror

Shumë komunitetet rurale janë të shenjua nga një frymë e kujdesit reciprok. Megjithatë, pabarazia sociale mund të gjendet kudo, me njerëz që vuajnë për shkak të të ardhurave të ulëta, mungesës së të drejtës për shërbime apo nga diskriminimi. Komunitetet rurale duhet të marrin rolin drejtues në ofrimin e kujdesit personave në nevojë. Ato duhet të jenë të vendosura në kërkesat këmbëngulëse drejtuar autoriteteve kombëtare dhe lokale për të siguruar një përfshirje sociale dhe për të siguruar burime për të moshuarit, të dobët dhe personat e tjerë që kanë nevojë për kujdes.



Fuqizimi i ekonomive lokale

Komunitetet e gjalla kanë nevojë për një bazë ekonomike të shëndoshë që të mund të lulëzojnë. Fermat e vogla dhe familjare shpesh janë zemra e ekonomive lokale dhe si të tilla duhet të mbështeten. Shumë zona rurale përballen me rënien e industrive tradicionale, kërcënimin e automatizimit, madje edhe mbylljen dhe zhvendosjen e biznesit. Ka shembuj premtues ku komunitetet rurale ja dolën të zhvillojnë ekonomi "të zgjuara" të reja bazuar në pikat e tyre të forta dhe sektorët ekonomikë më jetësorë. U bëjmë thirrje politikëbërësve kombëtarë dhe evropianë për të mbështetur këto eksperimente. Synimi duhet të jetë stimulimi i fuqizimit të strukturave ekonomike rajonale, duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm të NVM-ve dhe të kooperativave, dhe një vizion të përbashkët të zhvillimit dashamirës ndaj klimës. Një program i tillë përshtatet me qasjen e paraqitur së fundmi si një veprim i BE-së për fshatra të zgjuar.

Mirëpritja e personave të rinj në komunitet

Komunitetet rurale mund të jenë të mirë pozicionuar për të mirëpritur personat e rinj që po vijnë në Evropë si refugjatë apo imigrantë ekonomikë. Ka shembuj të mirë të veprimeve të tilla në disa vende. Por mirëpritja dhe integrimi i të ardhurve të rinj nuk është e lehtë. Rrjeti i Parlamentit Rural Evropian duhet të mbështesë shkëmbimin e eksperiencave praktike midis atyre që punojnë në këtë fushë. Së bashku mund të zhvillojmë një sërë mjetesh të bazuara në rrjet të praktikave të mira që asistojnë komunitetet në zhvillimin e iniciativave lokale.

Rinia

Të rinjtë janë thelbësorë për të ardhmen e zonave rurale. Të drejtat e tyre mbrohen nga Konventa e Kombeve të Bashkuara. I japim rëndësi të lartë mundësitimit të rinisë për të gjetur një jetë të mirë në fshat. Kjo përfshin shërbimet e mjaftueshme që përshtaten me nevojat e tyre si dhe përfshirjen e rinisë në zhvillimin e zonave rurale. Ne nxisim qeveritë, autoritetet publike dhe grupet LEADER që të sigurojnë që të rinjtë të mund të marrin pjesë në programet e financuara. I kërkojmë partnerëve të PRE-së që të lidhen me iniciativat e rinisë rurale dhe t'i mbështesin ata kudo që të jetë e mundur, për shembull duke përfshirë të rinjtë në iniciativat e komunitetit dhe duke mbështetur shkëmbimet ndërkombëtare midis të rinjve nga vende të ndryshme evropiane, dhe ndër të tjera, nëpërmjet takimeve si Parlamenti i Parë i Rinisë Rurale Evropiane, i mbajtur së fundmi.


Zhvillimi nga poshtë-lart, bazuar në vend

Takimi i PRE-së në Venhorst shfaqti entuziazmin e qytetarëve ruralë për t'u angazhuar për komunitetet e tyre dhe për të zhvilluar iniciativat e shumta për të përforcuar vitalitetin e zonave rurale. U bëjmë thirrje qeverive dhe institucioneve evropiane që të:

- njohin rëndësinë e nivelit lokal për të zhvilluar strategji kreative, të hapura dhe të përshtatura;
- investojnë në ndërtimin e kapaciteteve dhe të mbështesin ata qytetarë të cilët janë të gatshëm të angazhohen dhe investojnë një pjesë të konsiderueshme të kohës së tyre të lirë për komunitetin;
- përforcojnë partneritetin shumë-nivelesh të aktorëve publikë, privatë dhe shoqërisë civile; dhe të pajisin këto partneritete për të siguruar lidhjen munguese midis politikave në nivel kombëtar apo rajonal, dhe iniciativat në bazë në nivelin lokal;
- shtojnë vlerë të mirave lokale: u duhet dhënë prioritet investimeve të cilët rrisin njohuritë dhe kapacitetet e komunitetit dhe përmirësojnë përdorimin e qëndrueshëm të të mirave strategjike të tilla si peizazhi i cilësisë së lartë, trashëgimia kulturore, ushqimi dhe mbetjet.

Fond për Zhvillimin Lokal të Udhëhequr nga LEADER/Komuniteti

Këto qëllime duhet të pasqyrohen nëpërmjet një fondi për Zhvillimin Lokal të Udhëhequr nga Komuniteti, duke u bazuar në eksperiencën e gjatë të qasjes LEADER. Propozojmë që Bashkimi Evropian të krijojë një Fond të veçantë për zhvillimin lokal të udhëhequr nga komuniteti, me programe të koordinuara kombëtare dhe rajonale në vendet anëtare (shikoni deklaratën e Tartu). Ky Fond duhet të marrë një pjesë të konsiderueshme të fondeve për Investime Strukturore Evropiane (ISE). Përdorimi i tij duhet rezervuar për objektivat e vendosura nga strategjitë e udhëhequra nga komuniteti, pa asnjë dallim apo kufi midis fondeve të ndryshme të fondeve të ISE-së. Fondet duhet të dislokohen në mënyrë të decentralizuar, nëpërmjet partneriteteve lokale, në mënyrë që strategjitë lokale të mund të përgjigjen ndaj nevojave dhe sfidave lokale, sikundër e shpjegon diagrami më poshtë.



Vendet kandidatë, të pranuar dhe fqinje, të cilat përfitojnë nga sistemet e BE-së për ekonomitë e tyre rurale, duhet t'u mundësohet pjesëmarrja në konsultime të lidhura me politikën e reja të BE-së.

Kjo deklaratë është rezultat i një takimi frymëzues në të cilin përfaqësues nga komunitetet rurale në të gjithë Evropën shkëmbyen praktikën më të mira dhe mësimet e nxjerra. Bëjmë thirrje për një vijim të fuqishëm dhe të vazhdojë fushatën për të ardhme rurale të qëndrueshme, duke ndjekur arritjet tona nëpërmjet takimeve të PRE-së. Kjo Deklaratë do të mbështetet, brenda muajit vijues, nga një dokument shtesë i cili përfshin propozime të detajuara mbi këto tema, bazuar në punimet e PRE-së në Venhorst.

Ftojme institutet evropiane të marrin pjesë në këtë Deklaratë si një kontribut në diskutimin mbi kuadrin pas-2020 në BE. Ne përpiqemi për një Pakt mbi Komunitetet Rurale dhe Agjendën Rurale Evropiane për të mirëpritur kontributin dhe pjesëmarrjen tonë në shkallë evropiane, paralel me agjendën e "Paktit të Amsterdemit" për qytetet. Jemi të gatshëm të kontribuojmë në një marrëdhënie më të fortë midis qytetarëve në komunitetet tona dhe synimeve evropiane.